



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1903 Prot.

Tiranë, 25.4. 2019

URDHËR I BRENDSHËM

Nr.7 datë 24.04.2019

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR ANËTARIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UT, TË PROPOZUAR NGA STUDENTËT E UT

Në mbështetje të pikës 2 të Vendimit nr.4 datë 23.04.2019 të Rektoratit të Universitetit të Tiranës; të Vendimit nr.782 datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë"; si dhe të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nr.2459 prot. datë 15.03.2016, meqënëse në përfundim të afatit të përcaktuar në procesin e mëparshëm të zhvilluar në UT, në zbatim të shkresës nr.322 datë 14.01.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.782 datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë", nuk u paraqit asnjë kandidat,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurave të aplikimit për anëtarin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës, të propozuar nga studentët e Universitetit të Tiranës, nga data **23 Prill-10 Maj 2019**.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) si dhe Komisionet e Zgjedhjeve në fakultetet/filialin e Universitetit të Tiranës.
3. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Adresa: Sheshi "Nënë Tereza" Rektorati i UT, Tiranë, Tel: +355 4 258447/ Fax: +355 4 22 39 81